


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI



Nr. 333 / p. rot
13

Koplik më: 06/05/2022

V E N D I M

Nr 15, Datë 26 / 04 / 2022

P Ë R

**MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/NË PËRDORIM TË SIPERFAQES
PYJORE/KULLOSORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SHKREL ,BASHKIA MALËSI
E MADHE ME AFAT 10-VJECAR SIPERFAQËN PYJORE PREJ 0.5783 ha QË
SHTRIHET NË NGASTREN/NËNGASTREN 101/a BËN PJESË NË EKONOMINË
PYJORE “FUSHË E ZEZË” PËR QELTIME PUSHIMI ,ARGETIMI, VEPRIMTARI
TURISTIKE, KAMPINGJE.**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 26.04.2022 , në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika “e/1”, neni 9 pika 1.2, neni 27 pika 5, urdherit të Kryetarit të Bashkisë nr.17 datë 21.02.2022. Ligjin nr. 57/2020 “ Për Pyjet ”, Udhëzimin e Ministrit Të Mjedisit nr.1 dt.09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 2 germa a ,pika 7. VKM nr.391 dt.21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” , lidhja nr.2 pika 5/1 si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuara nga institucioni përkatës në kategorinë e përdorimit; si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave , “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive “, të ndryshuar.

VENDOSI:

1. Dhënie me qira /në përdorim të sipërfaqes pyjore/kullosore si më poshte:

SHKËMBIM

sipërfaqes pyjore prej 0.5783 ha që shtrihet në ngastren/nengastren 101/a, pjese e ekonomise pyjore "Fushe e Zeze". Vlera e qirase lekë /ha/vit do të jetë 100 000 (njëqindmijë) lekë/vit, llogaritur mbi raportin e studimit tekniko ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Malësi e Madhe për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike, kampingje të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, dhe tarifat e përcaktuara në VKM NR.1064/ datë 22.12.2010 lidhja 5.

2. Dhënien me qira për një afat 10 vjecar.
3. Miratimin e raportit teknik mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Malësi e Madhe për qëllime pushimi, argëtimi, veprimtari turistike, kampingje, të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve.
4. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 26.04.2022

Vota Pro 22

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 28.04.2022

